



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS LIPJAN

Numri i lëndës: 2020:028217

Datë: 22.02.2024

Numri i dokumentit: 05361243

C.nr. 365/2020

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË DEGA NË LIPJAN-Departamenti i Përgjithshëm, në përbërje prej gjyqtarit Zenel Tasholli, gjyqtar individual, në çështjen juridike kontestimore të paditëses Sh.C.H..nga fsh.K..e E.. K.G., të cilen me autorizim e përfaqëson A. H.. av. nga G...kundër të paditurës Komuna e Lipjanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me seli në Lipjan, me objekt kontesti kompensim i shpenzimeve të ushqimit dhe udhëtimit, vlera e kontestit 2,502-€, jashtë seance gjyqësore, me dt.22.02.2024 merr këtë:

A K T G J Y K I M

PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditëses Sh. C.. H..nga fsh.K.. e E.. K.G.,si e bazuar.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Arsimit, që në emër të kompensimit të shujtave për ditët në punë, t’ia paguaj paditëses pagën jubilarë për 10 vite përvojë pune 50% të një page bazë shumë prej **239.86€**, për ditë të punës për periudhën nga data 18.04.2017 deri me dt.25.03.2022 të përlllogaritur sipas shumë nga 2 euro në ditë shumë e përgjithshme prej në **1,472 -€**, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit nga 1.40-€ në ditë nga data 18.04.2017 deri me dt.25.03.2022 për 736 ditë pune në shumë prej **1,030-€**, me kamatë prej 8% nga dita e nxjerrjes së këtij aktgjykimi datë 22.12.2022, e deri në përmbushjen definitive të detyrimit të gjitha këto në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

III. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 238.00 euro .

A r s y e t i m

Paditësja, Sh.C.. H..nga fsh.K.. e E.. K.G., përmes të autorizuarit të saj A. H.. Av nga D.., në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Lipjanit – Drejtoria e Arsimit, sipas

bazës juridike kompensim i shujtave, sipas padisë paditësja është mësimdhënëse në SHMLM"Sh.. H.." në fsh.Sh..K.L., dhe e njëjta i plotëson kushtet e përfitimit të shujtës ditore sipas kushteve të parapara më Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, për çka pretendon se i takon kompensimi i ushqimit në punë shujtave ditore.

I autorizuari i paditëses përmes parashtrës së datës 11.05.2022 ka bërë precizimin e padisë duke kërkuar nga gjykata që e paditura t'ia kompensoj paditëses t'ia paguaj paditëses pagën jubilarë për 10 vite përvojë pune 50% të një page bazë shumë prej **239.86€**, për ditë të punës për periudhën nga data 18.04.2017 deri me dt.25.03.2022 të përlogaritur sipas shumës nga 2 euro në ditë shumë e përgjithshme prej në **1,472 -€**, si dhe në emër të shpenzimeve të udhëtimit nga 1.40-€ në ditë nga data 18.04.2017 deri me dt.25.03.2022 për 736 ditë pune në shumë prej **1,030-€**, të gjitha këto nga dita e paraqitjes së padisë deri në pagesën përfundimtare me kamatë prej 8%, si dhe shpenzimet e procedurës kontestimore që do të shkaktohen, poashtu i ka bashkangjitur edhe vërtetimet e punës, vërtetimin lidhur me udhëtimin dhe certifikatën e vendbanimit. Ndërsa me parashtrësën e dt.20.12.2022 ka bërë rregullimin e padisë sa i përket gabimit teknik të precizimit të dt.25.02.2022, ku në rreshtin e dytë në vend Komuna e Prishtinës Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në Prishtinë duhet të jetë Komuna e Lipjanit Drejtoria Komunale e Arsimit me seli në L...

Gjykata pas shqyrtimit paraparak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi. E paditura përmes përgjigjes së saj në padi të parashtruar me datë 02.09.2021, e ka kundërshtuar bazën juridike të kerkespadisë dhe se sipas nenit 90 pika 5 të Ligjit 03/L212 të Punës në të cilën thirret paditësi, ku thuhet se marrëveshja kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshje të tilla kolektive e që në rastin konkret e paditura Komuna e Lipjanit si punëdhënëse e paditësit nuk është nënshkruese e kësaj marrëveshje-kontratës kolektive në të cilën është thirrur pala paditëse. Më tutje ka shtuar se MASHT me nënshkrimin e kësaj kontrate nuk ka bërë harmonizimin e saj me Ministrinë e Financave, që Komunës me qarkore buxhetore të ju lejohet ngritja e tavanit të pagave, në mënyrë që të planifikojnë edhe pagesat shtesë për stafin arsimor në kuadër të kodit ekonomik paga dhe mëditje dhe me këtë rast e paditura nuk ka mundësi financiare ti paguaj. Gjithashtu dihet botërisht që mësimdhënësit nuk i përmbahen Kontratës së punës në bazë të së cilës përveç 20 orë mësimi në javë duhet të mbaj edhe 20 orë punë, gjë që nuk ndodh ngase punëtorët e arsimit i mbajnë orët e mësimi nga 4 apo 5 orë ndërsa orët e punës nuk i mbajnë fare. Poashtu nëse merret parasysh Kontrata Kolektive në nenin 46 par.2 shprehimisht thotë se pagesa e tillë si për kompensimin e ushqimit bëhet brenda mundësive institucionale, ligjore dhe financiare, e që konsideron se nuk janë plotësuar këto kushte, sepse të paditues nuk i janë ndarë

mjete financiare nga institucionet nënshkruese të Kontratës Kolektive.I ka propozuar gjykatës që konform dispozitave ligjore të LK-së nenit 399 par.1 dhe 2 padinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar-e pathemeltë.

Gjykata, pas pranimit të përgjigjes në padi, i ka vlerësuar kushtet ligjore nga neni 152 i Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), me të cilin përcaktohet se: *“po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundrejt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim”*, lidhur me nenet 143 dhe 147 të të njëjtit ligj, nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij, dhe ka gjetur se në këtë çështje juridike kontestuese plotësohen kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit pa shqyrtim kryesor.

Gjykata gjen se në rastin në fjalë zbatohen dispozitat e Kontratës Kolektive e Arsimit ne Kosovë (më tej KKAK) në Kosovë (KKAK) të miratuar dhe të nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës e Republikës së Kosovës, me datën 18.04.2017 (e cila është e zbatueshme prej datës së nënshkrimit të saj).

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: kontratën e punës për mësimdhënës nr.prot.04-112-813... dt.02.09.2019, vërtetimin nr.1/192 e dt.23.01.2020 të lëshuar nga SHMLM”Sh. H..” në fsh.Sh.. për ditët e pranisë në punë nga dt.18.04.2017 deri me dt.27.12.2019 për 459 ditë punë efektive, vërtetimin për përvojën e punës me nr.1767 te dt.21.11.2019 të lëshuar nga Gjimnazi “U...” K.Lipjanit, vërtetimin nr.1/23 te dt.22.11.2019 të lëshuar nga SHMLM”Sh. H..” në fsh.Sh.. për përvojën e punës së paditëses, vërtetimin nr.838 e dt.24.03.2022 të lëshuar nga SHFMU”K..D..” në fsh.K...për ditët e pranisë në punë nga dt.01.01.2020 deri me dt.31.12.2021 për 45 ditë punë efektive, vërtetimin nr.1/286 e dt.25.03.2022 të lëshuar nga SHMLM”Sh. H..” në fsh.Sh.. për ditët e pranisë në punë nga dt.13.01.2020 deri me dt.25.03.2022 për 232 ditë punë efektive, vërtetimin nga Kompania NTU”G..T..” me nr.biznesi.... me seli në N.. K.D..me biletë kthyesë në relacionin K..-N..në shumë prej 1.00€.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditëses është e bazuar dhe si të tillë e aprovoj në tërësi.

Në bazë të provave të sipërpërmendura dhe përgjigjes së dhënë në padi nga e paditura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura në SHMLM”Sh.H..” në fsh.Sh.. K.L...,mirëpo kontestuese është kompensimin i mjeteve në emër të pahes jubilarë, të shujtave ditore dhe shpenzimeve të udhëtimit, për periudhën

përkatësisht ditët si në dispozitiv këtij aktgjykimi, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovës të datës 17.04.2017 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK-ut, ku me dispoziten e nenit 2 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë e cila ka hyrë në fuqi me dt. 18.04.2017, parashihet se dispozitat e kesaj kontrate kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha insitucionet publike dhe private të Arsimit parauniversitar (para shkollor, fillor, të mesëm të ulët dhe të mesëm të lartë, Shkolla Speciale e Qendra të Kompetencës) dhe Institucione të Arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtar të SBASHK-ut, dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit ne sektorin e arsimit (komunal - DKA, KD te Universiteteve e institucioneve te arsimit te larte, MASHT-in etj) ne sektorin publik dhe institucionet edukativo – arsimore private ne mbarë territorin e Republikës së Kosovës, përkatësisht sipas nenit 35 par. 8 të Kontratës kolektive të arsimit parauniversitar të datës 18.04.2017, parashihet se *“Punëtorët (antarët e SBASHK-ut) që dalin në pension përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënsi i fundit dhe ate prej 50 % të një page bazë për 10 vjet të përvojës së punës”, 75 % të një page bazë për 20 vjet të përvojës së punës”, 100 % të një page,bazë për 30 vjet të përvojës së punës”, 150 % të një page bazë për 40 vjet të përvojës së punës”, me nenin 35 par.7 në të cilën përcaktohet se *“Të punësuarve, u sigurohet kompensimi për ushqim, gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore, punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restaurantit a kuzhinës, ose një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*”, ndërsa me nenin nenit 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë te dt. 18.04.2017, parashihet se punëtorët anëtar të SBASHK-ut punonjesit arsimor kompensohen për shpenzimet e udhëtimit prej 70% te çmimit të biletës, kjo gjykatë vlerëson se paditëses i takon e drejta e kompensimit për pagë jubilarë, shujtë ditore dhe shpenzime të udhëtimit gjatë punës përkatësisht për periudhën si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.*

Sipas nenit 8 parag.1 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve *“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”* ndërsa në dispozitat e nenit 245 parg.1 të LMD-së, ka paraparë se *“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”*, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se *“Marrëveshja Kolektive vlen*

për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”, meqenëse në rastin konkret është vërtetuar dhe nuk është kontestuese se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura lidhur me kërkesën për kompensimin për pagën jubilarë, kompensimin në emër të shujtës ditore për periudhën nga dt.18.04.2017-25.03.2022 dhe shpenzimeve të udhëtimit për periudhën nga dt.18.04.2017-25.03.2022, andaj të njejtat i aprovoj për periudhën gjatë të cilës paditësja ka punuar tek e paditura, në këtë gjendje të vërtetuar faktike e detyroj të paditurën që paditëses të ia paguaj shumat si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Andaj , meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi aprovimin e tërësishëm të kërkesëpadisë së paditësit .

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e të autorizuarit të të paditurës lidhur me ate se komuna nuk është nënshkruese e kontratës kolektive se nuk kanë parapara mjete financiare për shlyerjen e këtyre detyrimeve, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin e shujtave ditore obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se “Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se “Dispozitat e e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës” prandaj është edhe irelevante për këtë proces gjyqësor se si e paditura i siguron mjetet për kompensimin e këtyre kategorive.

Poashtu poqëse e paditura e konteston kërkesëpadinë, *përgjigja në padi duhet t'i përmbajë edhe faktet mbi të cilat i padituri i mbështetë thëniet e tij dhe provat me të cilat provohen faktet e tilla”, në çështjen konkrete juridike vlerëson se paditura nuk i ka bashkangjitur asnjë provë konkrete parashtrësës së përgjigjes në padi, me të cilat do ti vërtetonte pretendimet e saj.*

Gjykata lidhur me shpenzimet e procedurës, iu referua nenit 452, par.1 të LPK-së, dhe të autorizuarit të paditëses ia pranoi të drejtën e pagesës së shpenzimeve procedurale sipas pikës II të dispozitivit, në të cilën përcaktohet *“Pala e cila e humbë procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtare gjyqësore, dhe ndërhyrësit që i është bashkuar, t’ia shpërblejë të gjitha shpenzimet gjyqësore”*, ndërsa lartësinë e tyre e përcaktoi në përputhje me Rregulloren e Tarifës së Avokatëve të Kosovës e vitit 2017, gjegjësisht nr. tarifor 6 dhe 7, ndërsa për taksë gjyqësore iu referua Udhëzimit Administrativ për Taksa Gjyqësore nr. 01/2017, gjegjësisht nenit 12, par.1 të këtij udhëzimi ku përcaktohet lartësia e taksës gjyqësore, ashtu që e detyroi të paditurën që paditëses t’ia kompensojë në emër të shpenzimeve të procedurës kontestimore shumën prej 104 euro në emër të parashtrimit të padisë, për parashtrësë për precizimin e kërkespadiës shumën prej 104-€, si dhe shumën prej 30.00 euro në emër të taksës gjyqësore, në total shuma prej 238-€.

Duke u bazuar në të dhënat e lartcekura, gjykata ka vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në pajtim me dispozitat e cekura më lartë .

Gjykata Themelore në Prishtinë-Dega në Lipjan

Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil

C.nr.356/2020 me datën 22.02.2024

G j y q t a r i

Zenel Tasholli

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.